



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: SHKRIM AKADEMIK

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	JURIDIK I PËRGJITHSHËM
Titulli i lëndës:	SHKRIM AKADEMIK
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II, semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime:
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Merxhan Avdyli Asistenti:
Detajet kontaktuese:	Tel. 044 503 038; merxhan.avdyli@uni-gjilan.net email: sadovina@yahoo.com Facebook: Merxhan Avdyli
Përshkrimi i lëndës:	Shkrimi akademik do të përfshijë mësimin dhe praktikën në shkrimin e raporteve të ndryshme, eseve dhe llojeve dokumenteve dhe teksteve përkatëse. Ai do të përfshijë edhe shkrimin dhe leximin e punimeve me shkrim gjatë orëve mësimore. Nga studentët do të kërkohet të mbajnë një dosje të punimeve të tyre me shkrim, të cilat i kanë bërë gjatë kursit. Ata do të nxiten t'i

	publikojnë shkrimet e tyre profesionale në media të shkruara, për çka edhe do të vlerësohen. Studentët po kështu do të aftësohen për të shkruar, sepse shkrimi është shkathtësi esenciale për komunikim dhe nxënie dhe se të shkruarit promovon edhe aftësinë e të menduarit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i lëndës Shkrimi akademik është njohja e studentëve me nocionet thelbësore të të shkruarit intelektual - akademik. Studenti nëpërmjet ligjëratave, diskutimeve, leximit kritik, shkrimit të eseve dhe interpretimit të tyre, do të arrijë të përfitojë dije për realizimin e projekteve intelektuale, qoftë individualisht, qoftë në grupe. Shkrimi akademik, pos të tjerash, do t'u ndihmojë studentëve për të shkruar dhe interpretuar me sukses, çfarëdolloj dokumenti apo teksti, gjatë programit të përgatitjes së tërësishme në profesionin e tij. Shkrimi me sukses i një eseje, i një seminari, i një punimi shkencor apo i një diplome si në aspektin përmbajtësor, ashtu edhe në aspektin teknik, sikurse edhe në aspektin metodologjik, por edhe në atë drejtshkrimor do të jenë pjesë e kësaj lënde.
Rezultatet e pritura të nxënies:	➤ Të shprehin dhe demonstrojnë aftësitë e leximit dhe interpretimit kritik; ➤ Të demonstrojnë shkathtë në procesin e të shkruarit: gjenerimi i ideve, përgatitje e drafteve, rishikimi, editimi dhe prezantimi; ➤ Të shkruajnë drejt dhe sipas normave të kodifikuara fjalët dhe trajtat e ndryshme të tyre; ➤ Të aftësohen t'i vërejnë gabimet drejtshkrimore në tekste; ➤ Të shkruajnë ese për drejtimin përkatës; ➤ Të hartojnë dokumente dhe tekste të ndryshme (projekte, raporte, udhëzime, vendime etj.); ➤ Të bartin njohuritë dhe dijen në mjedise akademike;

	➤ Të publikojnë shkrimet e tyre autoriale në mediat e shkruara dhe të përgatiten për publikimin e botimeve të veçanta.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kolokuiume, seminare	2	10	20
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	5	5
Projektet, seminare, prezantimet etj.	2	5	10
Totali			125
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 5 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 125 orë			
Metodologjia e mësimdhënies:	➤ Ligjërata (forma e kombinuar – interaktive) ➤ Ushtrime (hartimi i punimeve shkencore, diskutimi i tyre në grupe dhe komunikimi interaktiv, lidhur me punimet e studentëve) ➤ Diskutime, debate rreth temave të ligjëruara ➤ Shkrim, interpretim ➤ Verifikim i dijes përmes testimit, nëpërmjet shkrimit të eseve, seminareve		
Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin		

	përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj) 15% - Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	➤ Eko, Umberto, <i>Si të bëhet një punim diplome</i>, "Dituria", Tiranë, 1997. ➤ Lewis, Jill, <i>Studimi akademik</i>, Tiranë, 2005. ➤ Memushaj, Rami, <i>Shqipja standarde</i>, "Toena", Tiranë, 2004. ➤ McMillan, Kathleen - Jonathan Weyers, <i>Ese dhe detyra univeristare</i>, CDE, Tiranë, 2010. ➤ <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i>, "Rilindja", Prishtinë, 1975.
Literatura shtesë:	➤ Boce, Elona <i>Si të shkruajmë një punim kërkimor</i>, CDE, Tiranë, 2004. ➤ Çausi, Tefik, <i>Fjalor i estetikës</i>, "Onufri", Tiranë, 1998. ➤ Dhrimo, Ali – Edmond Tupja, Eshref Ymeri, <i>Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe</i>, "EDFA", Tiranë, 2007. ➤ Musaj, Bardhyl, <i>Si të shkruajmë ese</i>, "Pegi", Tiranë, 2004. ➤ Nishku, Majlinda, <i>Procesi dhe shkrimet funksionale</i>, QAD, Tiranë, 2004. ➤ Pozzato, Maria Pia, <i>Semiotika e tekstit</i>, UET/Press, Tiranë, 2009. ➤ Shamiq, Mid'hat, <i>Si shkruhet vepra shkencore</i>, "Logos A", Shkup, 2006. ➤ <i>Gramatika e gjuhës shqipe I dhe II</i>, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002. <i>Fjalor i gjuhës së sotme shqipe</i>, Rilindja, Prishtinë, 1981..

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njohja me përshkrimin e lëndës, metodat, vlerësimin, burimet dhe literaturën Çka është shkrimi akademik
Java e dytë:	Nocionet themelore: gjuha; shkrimi; leximi kritik; shkrimi akademik; drejtshkrimi, drejtshqiptimi
Java e tretë:	Të shkruarit si formë komunikimi Procesi i të shkruarit Fazat e të shkruarit: planifikimi, shkrimi, rishikimi
Java e katërt:	Elementet e shkrimit kritik: qartësia; kuptimi; përshtatshmëria; logjika; elokuenca, gjuha, stili
Java e pestë:	Eseja dhe punimi shkencor Llojet e esesë (esetë sipas formës, esetë sipas tipologjisë) Tipat e punimit kërkimor (seminari, diploma, magjistratura, doktorata)
Java e gjashtë:	Drejtshkrimi i zanoreve dhe grupit të zanoreve Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve dhe grupit të bashkëtingëlloreve Testimi i parë: shkrimi i një eseje tematike
Java e shtatë:	Përdorimi i shkronjës së madhe Përdorimi i shenjave të pikësimit Fjalët me prejardhje të huaj dhe emrat e përveçëm të huaj
Java e tetë:	Procesi i punimit kërkimor: zgjedhja e temës; përzgjedhja e literaturës dhe shfrytëzimi i burimeve
Java e nëntë:	Struktura e një eseje Gjuha e një eseje dhe gjuha e një punimi shkencor
Java e dhjetë:	Testimi i dytë: një recension për një libër nga drejtimi përkatës

Java e njëmbëdhjetë:	Struktura e një punimi kërkimor: hyrja; tema (ndarja në kapituj), përfundimi, burimet dhe literatura
Java e dymbëdhjetë:	Citimi (llojet, mënyrat, format) Fusnota (llojet, format)
Java e trembëdhjetë:	Burimet dhe literatura (literatura bazë, literatura ndihmëse); bibliografia Aspektet teknike të një punimi
Java e katërbëdhjetë:	Rishikimi i një punimi Lektura Korrektura Redaktimi
Java e pesëmbëdhjetë:	Rekapitullimi i çështjeve kryesore të shkrimit akademik
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
➤ Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme; ➤ Vonesa mbi 10 minuta – nuk arsyetohet; ➤ Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë procesi mësimor; ➤ Nuk lejohet pëshpëritja gjatë procesit mësimor; ➤ Gjatë provimit final nuk lejohet kopjimi as pëshpëritja; ➤ Gjatë hartimit të eseve apo të seminareve nuk lejohet plagjiatura; ➤ Kontakti me mësimdhënësin e lëndës, lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse – mund të realizohet ditëve të parapara për konsultime, nëpërmjet postës elektronike apo kur është e nevojshme edhe përmes telefonit.	